



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

| Eksperti Shqyrtues | Data e autorizimit të ekspertit | Date e dorëzimit të raportit | Nr. i lëndës |
|----------------------|---------------------------------|------------------------------|------------------|
| samira sahiti | 19.07.2023 | 30.07.2023 | 2023/0497 |

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 17.07.2023, OE “PROGLOBAL SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0497, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Matja e hidrostatikes dhe rimbushja e aparateve kunder zjarrit” me nr. të prokurimit: "214-23-3593-2-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDASHME. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur për shërbime, vlera e parashikuar e kontratës: 108,000.00€, më Nr. 2023/0497 i dt:17.07.2023. Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1:

Neni 6:

Neni 7:

Neni 8:

Neni 28:

Neni 59:

Neni

Neni 72, të Ligjit Nr. 04/L – 042 per Prokurimin Publik Neni 38

Neni 97, të Rregullores Nr. 001/2022 per Prokurimin Publik

Deklaratë detale sipas OE ankues:

1. Kundër Vendimit të AK-Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës të datës 06.07.2023, dhe letres standarde per eliminim nga aktiviteti i prokurimit ne baze te nenit 109 te LPP se, paraqesim kete ANKESE pranë Organit Shqyrtues te Prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Matja e hidrostatikës dhe rimbushja e aparateve kunder zjarrit”, me numer prokurimi 214-23-3593-2-2- 1, me arsyet si ne vijim:

2. Autoriteti Kontraktues – Ministria e Punëve te Brendshme, aktivitetin e prokurimit e ka zhvilluar në menyre të kunderligjshme, duke vepruar ne kundershtim me dispozitat e LPP-se, gjithashtu duke mos e shqyrtuar ne teresi kerkesen e tenderuesit për rishqyrtim.

Kronologjia e ceshtjes

1. Permes letres standarde jemi njoftuar se jemi eliminuar nga aktiviteti i prokurimit me arsyet se:

2. Tenderi i juaj, eshte i papergjegjshem sepse nuk keni dorezuar Dëshmi te mjaftueshme. Sic, eshte pershkruar ne nenin 69 të LPP, qe tregojne arsyeshem se i permbushni kerkesat minimale te kapacitetit teknik/profesional te saktësuar ne dosjen e tenderit dhe ne njoftimin e kontrates.

Tenderi juaj eshte refuzuar, sepse gjate procedures se ekzaminimit, vleresimit dhe krahasimit te tenderit tuaj, komisioni i vleresimit ka konstatuar se nuk keni dorëzuar dëshmi të mjaftueshme, sic, është kërkuar te SEKSIONI II. FLETA E TE DHENAVE TE TENDERIT (FTD) në Dosje të tenderit (kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale Kapaciteti teknik dhe profesional), nr. i nenit 9.1 & 9.2 pika 2

4. AK-MPB, deri te ky konstatim ka ardhur në mënyrë të kundërligjshme duke mos vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, provat dhe dëshmitë që kanë qenë të paraqitura nga tenderuesi, ku me këtë veprim ka shkelur dispozitat e nenit 69 të LPP-së.

5. Organit Shqyrtues të Prokurimit i bëjmë me dije se në dosjen e tenderit i kemi paraqitur të gjitha dëshmitë e mjaftueshme të vlerësimit, referencat dhe kontratat, mirë po gjatë procesit të aplikimit për fitimin e tenderit në fjalë për shkak të një gabimi teknik ka ardhur deri te eliminimi nga aktiviteti i prokurimit.

6. Tek përshkrimi i referencave ka ndodhur një gabim teknik në datën e kontratës me Raiffeisen BANK Kosova, ku gabimisht është shkruar se “data e mbarimit të kontratës është data 18.01.2020, e që në realitet ka qenë data 12.05.2020”, ky gabim ka qenë lehtë i verifikueshëm për arsye se në dosjen e tenderit ka qenë e bashkëngjitur kontrata në të cilën është përcaktuar kohëzgjatja e kontratës.

Për shkak të këtij gabimi AK-MPB ka shkelur nenin 38, pika 4 të Rregullores nr.001/2022, Për Prokurimin Publik i cili shprehimist përcakton se “Autoriteti kontraktues do të sigurojë mundësinë e sigurimit të informacionit shtesë në kushte të njëjta për të gjithë Operatorët ekonomik dhe do të kërkojë informacion nga Operatorët ekonomik me qëllim të qartësimit të përmbajtjes së deklaratave të paqarta, certifikatave të përfshira në tenderë apo kërkesave për

pjesëmarrje. Sqarimi dhe kërkesa për informacion shtesë, informacion plotësues dhe dokumente është pjesë e procedurës së vlerësimit. Kërkesa kalon / nuk kalon dhe vlefshmëria e ofertave/aplikacioneve mund të vendoset vetëm pas dorëzimit të përgjigjeve në pyetjet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues dhe pas shqyrtimit të dokumenteve shtesë të paraqitura”, pra e njëjta ka qenë e obliguar që të njoftojë operatorin ekonomik që t’i jap informacione shtesë dhe të qartësojë përmbajtjen e gabimit në datat e përshkrimit të referencave.

8. Andaj, meqë në kërkesë për riqyrshim nuk janë marrë parasysh thëniet e tenderuesit, përmes kësaj ankese do të paraqesim edhe njëherë, se tenderuesi ka plotësuar të gjitha kushtet nga neni 69 të LPP- së, dhe do t’i paraqesim të gjitha, Kontratat, referencat, dhe raportet e kërkuara me këtë dispozitë.

9. Si Konzorcium: **PROGLOBAL SHPK & Pastor Kosova SH.P.K.**, bashkë me ofertë kemi dorëzuar,

- Listat e referencave – të bashkëngjitura me Kontratat, Referencat, Raportet e pranimit, faturat dhe transferet bankare,

- Si dëshmi për kontratat e ngjashme, të përfunduara në 3 vitet e fundit, deri në Njoftimin për kontratë, në përputhje me kushtet e FDT. Dëshmitë e dorëzuara dokumentare, plotësojnë dhe tejkalojnë shumën e përcaktuar prej 150,000.00 euro te kërkuar ne DT.

10. Më poshtë do të paraqesim edhe një herë Kontratat mbi projektet e ngjashme të përfunduara në laminë e shërbimeve të ngjashme, me **PROGLOBAL SH.P.K.**:

| Nr | Autoriteti kontraktues | Titulli i Kontratës | Data e fillimit të kontratës | Data e Përfundimit të kontratës | Shuma (€) |
|----|---------------------------------|--|------------------------------|---------------------------------|-----------|
| 1 | NPL Pallati I Rinise SH.A. | Mbushja dhe Servisimi I AKZ, Hidranteve, Aparateve te Zjarrfikes | 17.08.2021 | 17.08.2022 | 5 000.00 |
| 2 | MSU Carabinieri | Furnizim me aparate zjarrfikes | 17.02.2022 | 09.04.2022 | 2 671.88 |
| 3 | MSU Carabinieri | Mbushja dhe Servisimi i aparateve zjarrfikes | 17.03.2022 | 17.03.2022 | 1 994.80 |
| 4 | Korporata Energjetike e Kosoves | Furnizimi me Pjese per aparate zjarrfikes | 29.03.2022 | 29.04.2022 | 18 038.68 |
| 5 | Komuna e Gjakoves | Furnizim me mjete dhe paisje per shuarjen e zjarrit | 12.10.2021 | 12.11.2021 | 18 272.21 |
| 6 | Komuna e Podujeves | Furnizim dhe servisim te aparateve zjarrfikes | 04.03.3033 | 04.03.2023 | 8 309.20 |
| 7 | Termokos sha | Furnizim dhe Servisim te Aparateve zjarrfikes dhe Detektorve | 01.06.2022 | 01.08.2022 | 4 605.54 |
| 8 | MSU Carabinieri | Mbushja dhe Servisimi i aparateve zjarrfikes | 17.03.2022 | 17.04.2022 | 2 501.72 |
| 9 | MSU | Mbushja dhe Servisimi i | 17.03.2022 | 17.04.2022 | 859.90 |

| | | | | | |
|--|-------------|----------------------|----------------|--|------------------|
| | Carabinieri | aparateve zjarrfikes | | | |
| | | | TOTALI: | | 62 253.93 |

11. Kontratat dhe projektet e ngjashme të përfunduara në laminë e shërbimeve të ngjashme, me PASTOR KOSOVA SH.P.K:

| Nr | Autoriteti kontraktues | Titulli i Kontratës | Data e fillimit të kontrates | Data e përfundimit të kontratës | Shuma (€) |
|----|-------------------------------|--|------------------------------|---|-------------------|
| 1 | Banka Private për Biznes | Furnizimi, Kontrollimi dhe mbushja e aparateve kunder zjarrit | 15.06.2018 | 14.06.2020 | 4 250.50 |
| 2 | KOSTT | Mirembajtja, Kontrolli dhe Testimi I paisjeve per mbrojtje nga zjarrit | 30.08.2017 | 30.08.2020 | 13 907.74 |
| 3 | Raiffeisen Bank | Supply, service and maintenance of Fire Extinguishers for the RFB | 01.09.2020 | 30.09.2021 Vazhdimi edhe 2 vite – deri me 2023 | 22 115.53 |
| 4 | Raiffeisen Bank | Installation of security systems T001-01-19, Maintenance and servicing | 13.05.2019 | 12.05.2020 Vazhdimi edhe 2 vite – deri me 2022 | 147 820.03 |
| 6 | SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVES | Servisimi dhe Mirembajtja e aparateve kunder zjarrit | 03.12.2018 | 03.12.2021 | 69 206.00 |
| | | | TOTALI: | | 257 299.80 |

12. Në bazë të tabelave të paraqitura më lartë tenderuesi i plotëson të gjitha kriteret e nenit 69 të Ligjit për Prokurimin Publik, dhe të gjitha këto dëshmi do t’i paraqesim edhe si provë materiale bashkëngjitur kësaj anekse, gjithashtu i njëjti plotëson dhe tejkalon shumën e përcaktuar prej 150,000.00 euro te kërkuar ne DT.

13. Edhe në kërkesën për rishqyrtim edhe në këtë ankesë do të sqarojmë se arsye se pse me Raiffeisen BANK Kosova janë dy kontratat është se mirëmbajtja dhe servisimi është i ndarë për objektet për Zyrën Qendrore (Head Office) dhe për zyrat regjionale, sikurse që edhe faturimi bëhet ndaras.

· Kontrata me Raiffeisen BANK Kosovo J.S.C me titull

Sipas kontratës së datës 16.05.2019, Tenderuesi ka lidhur kontratë me Raiffeisen Bank Kosovo, për shitje, mirëmbajtje dhe servisim,

Sipas nenit 1 par.1.3 kohëzgjatja e kontratës është një (1) vit prej 13.05.2019 deri më 12.05.2020, me mundësi vazhdimi edhe për dy vite, ku e njëjta ka vazhduar edhe për dy (2) vite tjera deri më 2022.

SALE, PURCHASE AND MAINTENANCE AGREEMENT

Made in Prishtina, on 16th of May 2019 between the following Parties:

1. **Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C.**, HQ in Prishtina, UÇK Street, No. 191, (hereinafter referred to as “**Bank**”) and,

2. **Consortium Pastor Kosova SH.P.K and TEHNOINSPEKT L.L.C** established with Agreement for Participation in a Consortium, signed by the Latif Imeri the Director of Pastor Kosova SH.P.K and Dragan Stoevski the Director of TEHNOINSPEKT L.L.C, jointly represented by Latif Imeri with personal number 1004987981 (hereinafter referred to as “**Service Provider**”).

a) **Pastor Kosova SH.P.K** with UIN no. 810484775, business registration no.70026917, fiscal no.600069589, VAT no.330085846 located in 28 Nentori, LL-2, lok. 3/1, 41, Prishtinë, Kosova

b) **TEHNOINSPEKT L.L.C.** with business registration no. 5287740, VAT no. 4030999360077, located in Boris Trajkovski, P. Box 278, 10000 Skopje, Macedonia.

Article 1

Subject of the Agreement

1.1 The **Supplier** offers to sell, deliver and install to the **Bank, Fire Extinguishers** (hereinafter referred to as “**Goods**”) and perform maintenance of the **Fire Extinguishers** (hereinafter referred to as “**Maintenance Services**”) in accordance with the price, terms and conditions specified in the **Re-Offer no.079/2019 dated 15.05.2019**. The price includes all fees, taxes, duties and other charges, VAT, support and delivery expenses as well.

1.2 The **Bank** accepts the **Supplier’s** offer as stated in the previous paragraph of this Article and this offer shall be considered as an integral part of this Agreement.

1.3 The validity of this Agreement is one (1) year commencing on **13.05.2019** and ending on **12.05.2020** with the possibility of extension for a period of two (2) years if both parties agree.

1.4 In case of discrepancies between this Agreement and the **Supplier’s** offer, the terms and conditions of this Agreement shall prevail.

Aneksi per vazhdimin e kontrates dhe per 2 vite, 2020 – 2022:



Amendment III
TO SALE, PURCHASE AND MAINTENANCE AGREEMENT

Concluded in Prishtina, on 16-05-2019 between the following Parties:

1. Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C, HQ in Prishtina, Robert Doll Street, No. 99, (hereinafter referred to as “Bank”), and,
 2. Consortium Pastor Kosova Sh.P.K and TEHNOINSPEKT L.L.C established with agreement for participation in a Consortium, signed by Latif Imeri the Director of the Pastor Kosova Sh.P.K and Dragan Stoevski the Director of the TEHNOINSPEKT L.L.C, jointly represented by Latif Imeri with personal number 1004987981 (hereinafter referred to as “Service Provider”).
- a) Pastor Kosova SH.P.K with business registration no.70026917, NUI 810484775, fiscal no. 60039589, located in 28 Nentori, LL-2, lok. 3/1, 41, Prishtine, Kosove.
- b) TEHNOINSPEKT L.L.C with business registration no.5287740, VAT no. 4030999360077, located in Boris Trajkovski, P. Box 278, 1000 Skopje, Macedonia.

Contractual parties have agreed to amend the above mentioned dated Sale, purchase and maintenance agreement 16-05-2019 follows;

Article 1

Contractual parties have agreed to extend the duration of the sale, purchase and maintenance agreement dated 16-05-2019 only for maintenance for additional 2 (two) years, commencing on 13-05-2020 and ending on 12-05-2022

14. Kontrata e bashkëngjitur më lartë përfshinë shitjen, mirëmbajtjen dhe servisimin në Zyrë Qendrore Head Office, objekt 40 katësh, dhe objektet tjera me rëndësi të vecant në Prishtinë dhe Fushë Kosovë, dhënia e shërbimeve në bazë të kësaj kontratë është realizuar në shumën prej 147,820.03€, ku më poshtë do të paraqesim tabelen lidhur me transferet bankare,

Raiffeisen BANK Kosovo J.S.C. – nga Kontrata SALE PURCHASE AND MAINTENANCE AGREEMENT

Raiffeisen BANK Kosovo J.S.C. – nga Kontrata SERVICE AGREEMENT

Transferi 1: **7 531.15 Euro**, dt. 15.06.2021, nga fatura nr. 7321/2021, dt. 25.05.2021

Transferi 1: **4 118.05 Euro**, dt. 25.10.2021, nga fatura nr. 169/2021, dt. 28.09.2021

Transferi 1: **4 026.70 Euro**, dt. 05.01.2022, nga fatura nr. 185/2019, dt. 06.12.2021

Transferi 1: **1 424.38 Euro**, dt. 24.05.2022, nga fatura nr. 036/2019, dt. 27.04.2022

Transferi 1: **4 484.60 Euro**, dt. 11.01.2023, nga fatura nr. 048/2022, dt. 16.12.2022

Transferi 1: **530.65 Euro**, dt. 11.01.2023, nga fatura nr. 022/2023, dt. 24.04.2023

Totali: 22,115.53 Euro

Prova 2: Kontrata me Raiffeisen BANK Kosovo J.S.C. me titull: Service Agreement.

Prova 3: Referenca me RFB, date 20 Prill 2023

Prova 4: Fatura, Raporte pranimi/F.dergesat RFB

Prova 5: Transferet bankare për shërbimet e kryera në RFB, leshuar më 19/04/2023

Në Aneksi 1 - Specifikimet Teknike të Detyrueshme është kërkuar të bëhet dy here, Dmth, $2 \times 25\,574.40 \text{ euro} = 51\,148.80 \text{ euro}$ kostoja për pozicionin 8. Vetëm për njëherë që duhet bërë rimbushja dhe matja hidrostatike për pozicionin 8, OE me oferten jonormalisht të ulte, del se është për 2.5 here më të lirë. Me oferten e dhënë nga OE me cmimin më të lirë, nuk mund të bëhet (mbushja, matja hidrostatike, etj) dhe për pozicionet tjera për dy here si është kërkuar në DT.

KRITERET PËR VLERËSIM

2. Operatori ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë Projektet të ngjashme të përfunduara në lamin e shërbimeve të ngjashme (nga Njoftim për Kontratë për periudhën e shkuar trevjeçare) të gjitha së bashku në vlerë prej jo më pakë së 150,000.00 euro

2. Një listë të projekteve të përfunduara origjinalë të nënshkruar dhe vëlosur nga OE, të lëmisë së kërkuar për periudhën (nga Njoftim për Kontratë për periudhën e shkuar trevjeçare), duke bashkëngjitur referencat ose raportet e pranimit përfundimtar të shërbimeve.

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Komisioni i vlerësimit në bazë të eksaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave, ka konstatuar se për tenderin “Matja e hidrostatikës dhe rimbushja e aparateve kundër zjarrit”, janë pranuar tre (3) Tender (oferta) dhe në bazë të dokumentacionit të prezantuar në tenderët e tyre, të tre (3) tenderues janë të përgjegjshëm.

Prandaj komisioni rekomandon Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit anulimin e kësaj procedure të prokurimit, sipas nenit 62, pika 1. të LPP-se i cili parashihet me sa vijon:

Arsyeja e anulimit të procedurës së prokurimit publik -pas hapjes së tenderëve:

- një dispozitë në Ligjin e Prokurimit Publik kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit, nuk është pranuar asnjë tender i përgjegjshëm.

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

//

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

//

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

//

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **PROGLOBAL SH.P.K.**

Përgjigje në Pretendimi nr.1

KONSTATIM 1

Andaj, nga cka kemi cekur më lartë konsiderojmë se elimini nga aktiviteti i prokurimit i tenderuesit PROGLOBAL SH.P.K & PASTOR KOSOVA, është bërë në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik dhe Rregulloren për Prokurimin Publik.

- Pra, AK-MPB, kur ka vendosur që ta eliminoj tenderuesin nga aktiviteti i prokurimit, me arsyetimin se nuk ka bashkëngjitur referencat dhe dëshmitë dhe që nuk janë përmbushur kërkesat minimale të vlerës së përcaktuar në shumën prej 150,000.00€ të realizuar në tri vitet e fundit, e njëjta ka shkelur nenin 69 të LPP-së pasi që e njëjta ka paraqitur të gjitha kontratat, referencat dhe dëshmitë që varësisht nga institucioni përkatës që kemi bashkëpunuar ka lëshuar, dhe shumë minimale e përcaktuar nga

AK- MPB vetëm me dy kontratat me Raiffeisen Bank Kosova është arritur e tejkaluar.

- Në momentin që ka pasur paqartësi lidhur me përmbajtjen e listës së referencave dhe dëshimve të bashkëngjitura AK është obliguar që në bazë të nenit 38, pika 4 të Rregullores nr.001/2022, të kërkojë që dhe gjatë ri-vlerësimit të kërkojnë sqarime apo nëse është e nevojshme edhe verifikimi gjithmonë duke u respektuar në plotëni LPP dhe legjislacioni dytësor në fuqi për prokurim publik në Kosovë.

1. **Përgjigje:** Pretendim i bazuar OE ka dorëzuar dëshmi lidhur me kontratat e realizuar, referenca, transaksionet bankare si dhe kontrata me Raiffeisen Bank, po ashtu ka edhe dëshmi për projekte të tjera që e plotësojnë kërkesën e AK-së. AK e ka eliminuar këtë OE me arsyen se kontrata me Raiffeisen Bank ka përfunduar me **18.01.2020 sipas listës** dhe është me e vjetër se tri vitet e shkuara Njoftimi për Kontratë **13.04.2023**, kjo mos përputhje mes listës dhe përfundimit të kontratës me **datë 12.05.2020**, është dashur që AK të kërkojë sqarime konform nenit Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve pikës 2. “Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkojen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues”. Po ashtu neni 45.30 i lejon “Verifikimin e përshtatshmërisë, dhe nëse është e aplikueshme, kualifikimeve të ofertuesit, bëhet përmes Letrës standarde B45 “Kërkese për sqarimin e tenderit” përmes platformës elektronike”. Konsiderojmë se kontrata ka vlerë me shumë se sa një listë e plotësuar nga vetë AK, këtë mos përputhje AK është dashur të vërtetojë përmes mundësive ligjore të lartë përmendura.

Përgjigje në Pretendimi nr.2

KONSTATIM 2

OE me cmimin me te lire, ashtu si ka vleresuar AK ka ofruar cmime JONONORMALISHT te ulta (per 10 here me te lira), ndersa qe 2 OE tjere jane me cmime reale dhe te peraferta

Duke bere kalkulimin vetem per nje pozicion, psh:

Pozicioni 8, P 9kg/768 cope.

Cmimi i kg per Pluhur ABC sillet rrethe 2.60 Euro/kg

Nese i shtohet dhe shpenzimet per matjen hidrostatike qe duhet bere si dhe ndrrimi i pjeseve, kostoja per kg arrine rrethe 3.7

Cmimi i rimbushjes me pluhur ABC40 dhe Matja hidrostatike shumzohet me 9 per Aparatin zjarrfikes P9kg. Dmth eshte $9 \times 3.7 = 33.30$ euro/Cope

Sasia e Aparateve zjarrfikes eshte 768 cope

Kalkulimi per njehere eshte: $768 \text{ cope} \times 33.30 \text{ euro} = 25\,574.40 \text{ euro}$

Ne Aneksi 1 - Specifikimet Teknike te Detyrueshme eshte kerku te behet dy here,

Dmth, 2 x 25 574.40 euro = 51 148.80 euro kostoja per pozicionin 8

Vetem per njehere qe duhet bere rimbushja dhe matja hidrostatike per pozicionin 8, OE me oferten jonormalisht te ulte, del se eshte per 2.5 here me te lire

Me oferten e dhene nga OE me cmimin me te lire, nuk mund te behet (mbushja, matja hidrostatike, etj) dhe per pozicionet tjera per dy here si eshte kerku ne DT.

Përgjigje: Te ky rast nuk plotësohet kushti për tender jo-normalisht të ulët pasi AK nuk i ka tri (3) oferta të përgjegjshme, Rregullorja nr. 001/2022 për Prokurimin Publik neni 41.3 “Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar **për tenderët e përgjegjshëm**, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme : i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se **çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm**; ii. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët; iii. **janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë**”. AK nuk i ka tre OE të përgjegjshëm, në këtë rast mund te konsiderohet se kemi cmime manipulative.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim dhe gjatë rivlerësimit të kërkojnë sqarime apo nëse është e nevojshme edhe verifikimi i dokumenteve vetëm duke u respektuar në plotëni LPP dhe legjislacioni dytësor në fuqi për prokurim publik në Kosovë.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**PROGLOBAL SH.P.K.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Matja e hidrostatikës dhe rimbushja e aparateve kundër zjarrit**” me numër të prokurimit: “**214-23-3593-2-2-1**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **PROGLOBAL SH.P.K.**

samira sahi

